



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:012871  
Datë: 23.01.2024  
Numri i dokumentit: 05227323

**C – IV. – 14 – 1739**

**Paditësi :**

Xh M nga fshati R i Komunës së Prizrenit, e të cilin me autorizim e përfaqëson, av. B I nga Prishtina.

**Kundër**

**E paditura :**

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha”, nr.55 , Prishtinë.

**Objekti i kontestit .** Kompensimi i pagave mujore.

**Për:** Palët ndërgjyqëse.

**Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me dt.23.01.2024, nxjerr këtë:**

**A K T G J Y K I M**

**I. PRANOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit, Xh M nga fshati R i Komunës së Prizrenit e paraqitur kundër të të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë – Autoritetit i Likuidimit (AL) dhe **NDRYSHOHET pjesërisht**, Vendimi, PRZ017-0004/0252 i dt.10.03.2014 i të paditurës, Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoritetit të Likuidimit (AL), dhe **OBLIGOHET**, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditësit, t’ia kompensoj pagat e pa paguara për periudhën kohore prej dt.1 Gusht 2003 e deri me dt.19.12.2005, dhe atë për 5 (pesë) muajt e vitit 2003, 5 (pesë) paga mujore, në shumën prej **1,480,00 € (një mijë e katër qind e tetë dhjetë )**, për 12 (dy mbëdhjetë) muajt e vitit 2004, për 12 (dy mbëdhjetë) paga mujore, në shumën prej **3,552.00 € (tre mijë e pesë qind e pesë dhjetë e dy)**, dhe për 6 muajt e vitit 2005, 6 (gjashtë) paga mujore të vitit 2005, shumën prej **1,776.00 € (një mijë e shtatë qind e shtatë dhjetë e gjashtë)** e në shumën e përgjithshme prej **6,776,00 € (gjashtë mijë e shtatë qind e shtatë dhjetë e gjashtë )** si dhe shumën prej **677,60 € (gjashtë qind e shtatë dhjetë e shtatë e euro e gjashtë dhjetë centë )** në emër të kamatës ligjore

prej 10 %, si kërkesë aksesore nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim) dhe se shuma e pranuar, duhet të përmbushet në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit e nga shuma totale e kërkuar prej 10,641.00 € për pagat e të pa paguara për periudhën duke filluar nga muaji 1 Korrik i vitit 1999 e deri me dt.19.12.2005.

**II. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit, Xh M nga fshati R i Komunës së Prizrenit e paraqitur kundër të të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë – Autoritetit i Likuidimit (AL) për kompensimin e pagave të papaguara mbi pjesën e pranuar e për periudhën prej 1 Korrik 1999 e deri në muajin Korrik të vitit 2003 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim) dhe mbi shumën e pranuar si dhe kamatë vonesën sipas ligjit në fuqi dhe Vendimi, PRZ017 - 0004/0252 i dt.10.03.2014 i të paditurës, Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), **VËRTETOHET pjesërisht, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

**III. PRANOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesa e paditësit, Xh M nga fshati R i Komunës së Prizrenit për caktimin e shpenzimeve procedurale, **CAKTOHEN pjesërisht** shpenzimet procedurale dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën 208,00 €, si dhe në emër të shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore për padi, shumën prej 30.00 € e në shumën e përgjithshme prej **238.00 € (dy qind e tri dhjetë e tetë)** dhe **DETYROHET**, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL) që paditësit, Xh M nga fshati R i Komunës së Prizrenit, t’ia kompensoj shpenzimet e pranuar procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

**IV. REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar** kërkesa e paditësit, Xh M nga fshati R i Komunës së Prizrenit për caktimin e shpenzimeve gjyqësore, dhe atë në emër të shpenzimeve për kërkesën e drejtuar Autoritetit të Likuidimit (AL) në shumën prej 104.00 € për shqyrtimin e shkresave të lëndës në shumën prej 104.00 € si dhe në emër të shpenzimeve për kundërshtimin e mbrojtjes së të paditurës, AKP-së, në shumën 208,00 €.

#### **Rrethanat Faktike dhe Procedurale:**

Me dt.18.04.2014, paditësi, Xh M nga Prizreni, përmes postës, dhe përfaqësuesit të autorizuar pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (DhPGJSK), ka parashtruar ankesën e ushtruar kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRZ017-0004/0252 dt.10.03.2014, e me të cilin i është refuzuar si e pavlefshme kërkesa për kompensimin e pagave të ta papaguara për periudhën 1 korrik 1999 - 15 dhjetor 2005, në shumë prej 10.641.00 euro, dhe se me dt. 30 shtator 2015, ka paraqitur parashtrësën për plotësimin e padisë me të cilën ka shtjelluar pretendimet e paraqitura edhe në padinë e dt.18.04.2014, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave juridike dhe detyrimet ndërkombëtare juridike dhe ligjore të punëdhënësit, me kërkesë që të miratohet në tërësi e bazuar padia e paditësit dhe të anulohet vendimi PRZ017-0004/0252 dt.10.03.2014, lidhur me NSH “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim), të obligohet e paditura që në emër të pagesës së pagave të papaguara ti paguaj paditësit shumën e borxhit kryesor prej 6.452.00 euro dhe kamatën ligjore për vonës prej 3.5 % e borxhit kryesor prej dt.01.01.2008, dhe kamatën prej 8 % prej dt.10.07.2013, dhe shpenzimet e përfaqësimit në bazë të Tarifës së avokatëve në shumë prej 104, dhe të gjitha shpenzimet tjera.

Pala paditëse parashtrësën e ka titulluar si “ankesë” mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtrësave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi në këto parashtresa të paraqitura në mes tjerash ka theksuar se paditësi dhe punëtorët e tjerë, u është ndërprerë në mënyrë masive kontrata e punës dhe rrjedhimisht kanë të drejtë në paga të papaguara, dhe se AKP nuk e kishte mohuar këtë, dhe AKP kishte refuzuar këto kërkesa duke pretenduar se kërkesa për paga të papaguara është parashkruar, ndërsa siç shihet nga listat e pagave të përgatitur dhe nënshkruar me një listë përmbledhëse të dt.01.07.1999 - 19.12.2005, ku shihet se paditësi, Maliqi është radhitur në nr.252 të Listës përmbledhëse dhe nën numrin rendor 87 të listës mujore të pagave. Pretendimet e parashtruesit në kundërshtimin e Vendimit, PRZ017-0004/0252 dt.10.03.2014, i referohen duke cituar dispozita nga Ligji për AKP (Ligjit për Ndërmarrjet i RSFJ-së 1989-1990, Ligjit të Punës së KSAK Rregullores së UNMIK mbi Ligjin e Punës në Kosovë, nr.2001/27, Ligji mbi Trustin e pensioneve në Kosovë dhe Ligjit mbi tatimin në paga), me njoftim për gjykatën se nëse kontestohet kjo padi, kërkon nga e paditura që të paraqet në gjykatë dokumentacionin e plotë të NSH, “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim), listat e pagave, evidencën e punëtorëve, kopjet e librave amë dhe dokumentacioni tjetër relevant për këtë çështje, se ka konsideruar se i plotëso kushtet themelore të cilat duhet të përmbushen për të pasur të drejtë në pagat e pa paguara, e me sa vijon :

Duhet të ekzistoj marrëdhënia e punës në mes NSH-së dhe punëtorit;  
Punëtori duhet të ketë qenë duke punuar apo ofruar shërbime ndaj NSH-së;  
Punëtori nuk është paguar për punën dhe shërbimet e kryera ndaj NSH-së;  
Punëtori duhet të ketë qenë i varur nga marrëdhënia e punës me NSH-në si dhe  
Punëtorit nuk i është dhënë bonusi social.

Në kontestimin e zbatimit të dispozitave ligjore nga AKP-, ka cituan nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, praktikën gjyqësore të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, duke cituar edhe zbatimin e nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ, si dhe pretendimet në kërkesa bazuar në dispozitat e LMD-së për kamatëvonesë, të drejtën për dëmshpërblim dhe shpenzimet procedurale sipas LPK-së.

Padisë së tij, ia ka bashkangjitur provat kopje siç janë: Vendimin, PRZ017-0004/0252 të dt.10.03.2014, petitionin për lirim nga taksa gjyqësore.

Me dt.08.11.2023, e paditura AKP-ja, ka parashtruar mbrojtjen e saj në ankesën e paraqitur nga pala paditëse ndër të tjera ka theksuar se me rastin e vendosjes, Autoriteti i Likuidimit, ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme janë zbatuar saktë, dhe se ankesa e parashtruar nga parashtruesi nuk ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë siç parashihet me nenin 74.2 të Ligjit nr. 04/L- 034 për AKP-në, duke theksuar se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit nr. 04/L- 034 për AKP është shkelur, dhe se vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të ligjit për AKP dhe nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin dhe se ankesa është e pabazuar. Më tej citon se pretendimet e parashtruesit janë të pabazuar në ligj dhe parashkruara për kërkesën, PRZ017-0004/0252, sipas nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, parashikon se “elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”, dhe nga nenin 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 1999/24, parashikon që: “pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”, andaj bazuar në dispozita e mësipërme kërkesat duhet të jen paraqitur në gjykatë apo te ndonjë autoritet kompetent më së voni deri 1 korrik 2002. Në përfundim i paraqet gjykatës që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL-së.

Më dt.22.11.2023, i autorizuari i paditësit, av.B I, ka paraqitur përgjigje në mbrojtjen dhe kërkesë për caktimin e seancës gjyqësore, duke kundërshtuar qëndrimet e paditurës lidhur me parashkrimin, dhe duke përsëritur qëndrimet e paraqitura edhe në parashtrësat e mëparshme, njashtu edhe propozimin për marrjen e aktgjykimit. Parashtrësës i ka bashkangjitur provat kopje siç janë: njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, librezën e punës dhe listën e pagave si dhe i ka kërkuar dhe specifikuar edhe shpenzimet procedurale e të cilat i kërkon nga e paditura dhe atë për kërkesën e drejtuar tek AL-ja , shumën prej 104,00 €, në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 208,00 €, në emër të kundërshtimit të mbrojtjes së të paditurës, AKP-së, shumën 208,00 €, si dhe në emër të pagesës së taksës gjyqësore për padi, shumën prej 31.00 € si dhe për kundërshtimin e mbrojtjes së AKP-së, shumën prej 104.00 € e sipas numrave gjegjës tarifor sipas Odës së Avokatëve të Kosovës, e gjithsejtë në shumën prej 655.00 € e më gjerësisht si në këtë përgjigje dhesë kësaj përgjigje, ia ka bashkangjitur, kopjen e njoftimit të dt.21.02.2026 për përfundimin e punësimit, kopjen e librezës së punës, dhe Listën e të ardhurave personale të pa paguara të punëtorëve të NSH “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren.

Me dt.11.12.2023, DhPGJSK-ja, me Urdhrin e saj, C – IV. – 14 – 1739 të dt.11.12.2023, ka urdhëruar Xh M nga fshati R i Komunës së Prizrenit, që në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditës së pranimit të këtij urdhri, t’a plotësoj padinë (ankesën) e tij të dt.18.04.2015 të ushtruar kundër Vendimit të AL-së, PRN017 – 0004/0252 të dt.10.03.2015, dhe atë në përputhje me dispozitat ligjore të lartë cekura e duke e precizuar shumën e një page mujore që e ka pasur tek Ndërmarrja Shoqërore (NSh), “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim) dhe kësaj padie (ankese), t’ia bashkangjes, dokumentin gjegjës zyrtar e nga i cili do të provohej lartësia e një pagës mujore që paditësi e ka marr apo e ka pasur tek kjo NSh e për kompensimin e pagave të ta papaguara për periudhën 1 korrik 1999 - 15 dhjetor 2005, në shumën prej 10.641.00 euro, si dhe provat tjera në mbështetje të padisë (ankesës) së tij e me vërejtjen se nëse paditësi, nuk vepron brenda afatit të dhënë sipas pikës I të dispozitivit të këtij urdhri, gjykata në bazë të nenit 36 të Ligjit, Nr.06/L – 086 të dt.30 maj 2019 të Dhomës e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), padinë/ankesën e saj, do të Hedh poshtë si të papranueshme ose të njëjtën padi (ankesë), do të refuzoj si të pabazuar.

Me dt.18.12.2023, paditësi, i është drejtuar kësaj gjykate me Përgjigjen e tij e në të cilën ka përsëritur qëndrimet e tij të cekura sikur se në Përgjigjen e tij të dt.22.11.2023 të dhënë në mbrojtjen e të paditurës, AKP-së si dhe kësaj Përgjigjeje, ia ka bashkangjitur provat e njëjta sikurse ato të bashkangjitura Përgjigjes së tij të dt.22.11.2023.

Me dt.18.12.2023, DhPGJSK-ja, me Urdhrin e saj, C – IV. – 14 – 1739 të dt.18.12.2023, Përgjigjen e paditësit, ia ka dërguar të paditurës dhe se me të njëjtin Urdhër, e ka detyruar të paditurën që të siguroj evidencën gjegjëse e nga e cila do të provohej sesa ka qenë paga mujore e paditësit tek NSH, “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim).

Me dt.29.12.2023, e paditura është përgjigjur në Urdhrin e kësaj gjykate, C – IV. – 14 – 1739 të dt.18.12.2023, e në të cilin ka theksuar se paditësi, në listën e pagave të NSH-së në fjalë, ka qenë në numrin rendor 19 dhe ka pasur pagë mujore gjegjëse bruto dhe se kësaj Përgjigjeje, ia ka bashkangjitur Listat e pagave të punëtorëve të NSH, “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim) për muajt Janar – Korrik 2003 dhe se paga mujore e paditësit, për muajin Janar, 2003, ka qenë në shumën prej 293.00 €, për muajin Shkurt, 2003 në shumën prej 312.00 €, për muajin Mars, 2003 në shumën prej 281.00 €, për muajin Prill, 2003 në shumën prej 243.00 €, për muajin Maj, 2003 në shumën prej 295.00 €, për muajin Qershor 2003 në shumën prej 296.00 €, dhe për muajin Korrik, 2003, ka qenë në shumën prej 296.00 €.

Me dt.04.01.2024, DhPGJSK-ja, me Aktvendimin e saj, C – IV. – 14 – 1739 të dt.04.01.2024, e ka urdhëruar të paditurën, AKP-ja me seli në Prishtinë, që në afatin prej 3 (tre) ditëve pas ditës së pranimit të këtij urdhri, pranë kësaj gjykate, duhet të parashtroj/dorëzoj, dokumentin gjegjës zyrtar e nga i cili do të provohej lartësia e një page mujore që paditësi e ka marr apo e ka pasur tek Ndërmarrja Shoqërore (NSh), “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim) për periudhën kohore para vitit 2003 e që lidhet me kërkesën e bërë nga paditësi për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën 1 korrik 1999 - 15 dhjetor 2005, në shumën prej 10.641.00 €, si dhe provat tjera në mbështetje të pretendimeve të saj.

Me dt.22.01.2024, e paditura, AKP me seli në Prishtinë, i është drejtuar kësaj gjykate me Përgjigjjen e saj e në të cilën ka sqaruar se sa ka qenë paga mujore e paditësi, gjatë vitit 2002 dhe se kësaj përgjigjeje, ia ka bashkangjitur, listën e të ardhurave mujore për Ndërmarrja Shoqërore (NSh), “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim), e sipas së cilës, paditësi, ka qenë i renditur treknr.19 dhe ka pasur pagën gjegjëse mujore gjatë vitit 2002 e duke filluar prej shumës 178,00 € e deri në shumën prej 269,00 € .

### **Arsyetimi ligjor:**

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban padia/ankesa/kërkesa, dhe gjykata merr aktgjykim, pa caktuar seancën dëgjimore.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit, duhet të pranohet pjesërisht si e bazuar për një pjesë të saj e pjesërisht duhet të refuzohet si e pabazuar për një pjesë të saj.

### ***Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.***

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, dhe ka konstatuar, se NSH “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim) dhe se e Autoritetit i Likuidimit (AL) sipas Njoftimit të AKP-së të dt.21 shkurt 2006, se si pasoj e shitjes së asetëve punësimi i juaj do të përfundoj menjëherë ... pala paditëse pranë Autoritetit të Likuidimit (AL), me dt.01.08.2006, pra brenda afatit ligjor, ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën 1 korrik 1999 - 15 dhjetor 2005 në shumën prej 10.641.00 €, nga NSH “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim dhe se Autoriteti i Likuidimit pasi që ka bërë vlerësimin e kërkesës së parashtruar nga paditësi dhe se me vendimin PRZ017-0004/0252 dt.10.03.2014 të AL-së, kërkesën në fjalë të paditësit, ia ka refuzuar si e pa vlefshme derisa paditësi, pas pranimit të këtij aktvendimi në procedurën e likuidimit, ankesën kundër Vendimit të Autoritetit të

Likuidimit të Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, pranë DhGjSK-së, e ka paraqitur përmes dërgimit me postë me dt.18.04.2014, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditëve.

Gjykata, vlerëson se padia/ankesa e paditësit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë nga dispozitat e nenit 36 dhe nenit 74 Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP).

***Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.***

Gjykata vlerëson se në mes palëve ndërgjyqëse, nuk është kontestuese se paditësi me të paditurën, NSh, “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim), kanë pasur raport të marrëdhënies së punës nga dt. 26.03.1979 – 21.02.2006, dhe atë sipas Librezës së punës me nr. Regj.16215, por kontestuese mbetet çështja e bazës ligjore lidhur në numrin e pagave të kërkuara, për të cilën paditësi pretendon se ka të drejtë që të kërkoj nga e paditura, Ndërmarrja Shoqërore, “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim), për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën 1 korrik 1999 e deri më 15 dhjetor 2005, në shumë prej 10.641.00 euro dhe se kërkesa e paditësit për pagat e pa paguara, a është brenda afatit të paraparë ligjor apo jo.

Në nenin 6 të Ligjit Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për fushëveprimin e kompetencave administrative të Agjencisë, aty thuhet se :”Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2. ....” .

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditësit, ka të bëjë me kërkesat e pa siguruara - pagat e pa paguara në nenin 40 par.1 pika 7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në e në të cilin, parashihet se:”*Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pasiguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë*”.

Për çështjen e pagesës së pagave të një punësuarit në një ndërmarrje në nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/27 i dt.8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës), ka qenë e paraparë se : “*Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës*” kurse në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : “*I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...*” kurse nenin 67 të Ligjit të Punës, Nr. 03/ L-212 të dt.1 nëntor 2010, që flet për Ndërprerjen e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore, aty thuhet se :” *Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: ... 1.8. me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes*” ndërsa në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : “*I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...*”. Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – civile, kërkesëpadinë/ankesën e paditësit të ushtruar kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRZ017-0004/0252 dt.10.03.2014 për NSH “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim), për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën 1 korrik 1999 - 15 dhjetor 2005, në shumë prej 10.641.00 euro, duhet t’a pranoj pjesërisht si të pabazuar për një pjesë të kërkesëpadisë së tij derisa për një pjesë të saj si dhe kamatë vonesën duhet t’a refuzojë si të pabazuar.

Gjykata vlerëson se pjesërisht qëndron pretendimi i paditësit se kërkesa e tij në procedurën e likuidimit gjegjësisht nga Autoriteti i Likuidimit. duhej të pranohej sipas kërkesës së tij, pasi që AL-ja me rastin e refuzimit të kërkesës së tij si të pa vlefshme, pjesërisht ka zbatuar drejtë dispozitat nga neni 36.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, dhe nga neni 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.1999/24 e për të cilën gjykata gjen se me rastin e zbatimit të dispozitave ligjore AL-ja, pjesërisht në mënyrë të gabuar ka zbatuar dispozitat lidhur me parashkrimin e detyrimit në të holla për një pjesë të tij e në emër të pagave të pa paguara për një periudhë kohore e pjesërisht i ka zbatuar drejtë këto dispozita për një pjesë të detyrimit në të holla në emër të pagave të pa paguara për një periudhë kohore pasi që kërkesa e paditësit është e bazuar pjesërisht në fakte dhe prova të besueshme pasi që kërkesa e pretenduar për paga të papaguara duhet të mbështet në fakte dhe prova të besueshme ligjore, për të cilin kërkesëpadi, paditësi vetëm pjesërisht ia ka paraqitur gjykatës faktet dhe provat gjegjëse.

Gjykata vëren se kërkesa e parashtruar nga paditësi, është brenda afatit të paraparë ligjor për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara nga NSH-ja në fjalë, si palë e paditur pasi që paditësi, ka arritur që të bind gjykatën se me kohë ka inicuar kërkesën pranë AL-së për kompensimin e pagave të pa paguara, pra nga data kur ka filluar të mos merr të ardhura nga Ndërmarrja në të cilën ka punuar dhe se pas kërkesës së kësaj gjykate për sjelljen e provave gjegjëse, padisë së tij, ia ka bashkangjitur provat gjegjëse siç janë : librezën e punës, njoftimin e dt.21 Shkurt 2005 të lëshuar nga AKP-ja për përfundimin e punësimit te Ndërmarrja Shoqërore, (NSH), “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim) dhe Listën e të ardhurave personale të pa paguara të punëtorëve të NSH “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren e të cilat prova e provojnë pjesërisht pretendimin e tij, se të njëjtit i takon kompensimi në emër të pagave të pa paguara për periudhën gjegjëse kohore e për shkak të përfundimit të punësimit nga e paditura kurse pjesërisht pretendimi i tij, është i pabazuar për një pjesë të kërkesës së pagave të pa paguara për periudhën gjegjëse kohore.

Në bazë të nenit 31 par.1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përcaktohet se: *”Palët, në parashtrësit e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës”* kurse në nenin 36 par.2 pika 1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, parashihet se *“... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”* derisa në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (I publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë, parashihet se: *“Pagesa e shumës së pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”* e për më tepër edhe në nenin 87 të Ligjit të Punës, Nr.03/L – 012, gjithashtu, parashihet afati i njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës.

Përkitazi me çështjen e pretendimit të të paditurës për parashkrimin e kërkesës së paditësit për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara për shkak të përfundimit të punësimit te NSH-ja në fjalë, gjykata vlerëson se një pretendim i tillë i të paditurës, nuk mund të qëndroj sepse paditësi, njoftimin e AKP-së për përfundimin e punësimit, e ka pranuar me dt.21.02.2006 e ka pranuar e në të cilin ceket se : *”Në mënyrë që të mbrohet dhe të shtohet perspektiva e aseteve dhe e veprimtarisë biznesore të kryer nga punëdhënësi i juaj, .... dhe se pasojë e shitjes së aseteve, është përfundimi i punësimit tuaj për arsye të tepricës dhe se kjo letër është njoftim zyrtar për ju se punësimi juaj përfundon menjëherë dhe shumat – pagat që u janë borxh juve*

*sipas kontratës tuaj të punësimit, do të mbesin përgjegjëse e punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit, dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedurat*”. Gjykata konstatoj gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, dhe se pas shikimit në shkresat e lëndës, ka gjetur se paditësi, pjesërisht e ka ruajtur afatin për të kërkuar pagat e pa paguara për periudhën kohore prej dt.1 Gusht 2003 e deri me dt.19.12.2005 dhe se sipas një përllogaritje të bërë nga totali i shumën së kërkuar (sipas pagës mesatare prej 296,00 €) për pagat e pa paguara prej 10,641.00 €, dhe se sipas Listës së të ardhurave mujore të punëtorëve të NSh, “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim) për muajt Janar – Korrik 2003 dhe se nga kjo listë paga mujore e paditësit, për muajin Janar, 2003, ka qenë në shumën prej 293.00 €, për muajin Shkurt, 2003 në shumën prej 312.00 €, për muajin Mars, 2003 në shumën prej 281.00 €, për muajin Prill, 2003 në shumën prej 243.00 €, për muajin Maj, 2003 në shumën prej 295.00 €, për muajin Qershor 2003 në shumën prej 296.00 €, dhe për muajin Korrik, 2003, ka qenë në shumën prej 296.00 €, andaj paditësit, i takojnë për muajit Korrik – Dhjetor të vitit 2003, 5 (pesë) paga mujore në shumën prej 1,480,00 € (5 x 296.00 € = 1,480.00 €), për vitin 2004, 12 paga mujore, shumën prej 3,552.00 € (12 x 296.00 € = 3,552.00 €), dhe për vitin 2005, 6 (gjashtë) paga mujore, shumën prej 1,776.00 € (6 x 296.00 € = 1,776.00 €) e në shumën e përgjithshme prej 6,776,00 € (1,480,00 € + 3,552.00 € + 1,776.00 € = 6,776.00 €) kurse për periudhën kohore prej 1 Korrik 1999 deri më 30 Korrik.2005, kërkesa e paditësit për pagat e pa paguara, është e parashkuar.

Gjykata vlerëson se pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit për pagat e pa paguara për periudhën kohore duke filluar prej 1 Korrik 1999 e deri në muajin korrik i vitit 2003 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), “NIN Ramiz Sadiku” me seli në Prizren (në likuidim), është e parashkuar sepse paditësi, nuk ka ofruar prova se para dt.1 Gusht 2006, t’i ishte drejtuar gjykatës apo te ndonjë autoritet kompetent më së voni deri 1 korrik 2002, pra brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, supozohet të mos ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj paditësit, pra AL-ja me anë të Vendimit të tij, PRZ017-0004/0252 i dt.10.03.2014 si dhe përmes mbrojtjes (Përgjigjjes së dhënë në padi) e saj, AKP-ja si ndaj rastit të ngjashëm lidhur me institutit të parashkrimit, i referohet nenit 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.03/L – 034 të AKP-së dhe nenit 608 pika 1 të Ligjit për Punën e Bashkuar (LPB) (Gazeta zyrtare e RSFJ 53/76) dhe se këtë përfundim të të paditurës, AKP-së, gjykata e konsideron si aplikim të gabuar të dispozitave ligjore, nga arsyet si në vijim. Sipas nenit 608 në paragrafin 2 të LPB-së, parashihet se :*“Në parashkrimin e kërkesave sipas pikës 1 të këtij neni në mënyrë të ngjashme aplikohen rregullat e përgjithshme mbi parashkrimin e kërkesave, në rastet kur ato kërkesa parashkruhen për tri vite”*.

Përkitazi me çështjen e parashkrimit, në nenin 360 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978 e që flet për Rregullat e përgjithshme të parashkrimit, aty, parashihet se :*“Me parashkrimin pushon e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Gjykata nuk mund të përfillë parashkrimin në qoftë se debitori nuk e ka invokuar atë”*.

Për më tepër për kërkesat periodike, siç është në rastin konkret, bëhet fjalë në nenin 372 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978, që bënë fjalë për kërkesa periodike, aty thuhet se :*“Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) si kur është fjala për kërkesat periodike aksesore, sikundër është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është fjala për kërkesën periodike të atilla ... parashkruhen tre vjet nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë”*. Në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesat për pa gat e pa paguara e të cilat kanë natyrë periodike dhe këto kërkesa parashkruhen në afatin prej tre vjetëve nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë. Po ashtu dispozitë të ngjashme ka edhe në nenin 353 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e



Detyrimeve (LMD), Nr.04/L-077 të dt.10 maj 2012, që flet për kërkesat periodike e në të cilin, thuhet se : *''Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) ....''*.

Përkitazi me ndërprerjen e parashkrimit, në nenin 388 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978, flitet për ndërprerjen e parashkrimit, e ku është përcaktuar se: *''Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës''*. Derisa dispozitë të ngjashme për ndërprerjen e parashkrimit për shkak të ngritjes së padisë, ka edhe neni 369 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), nr.04/L-077, e në të cilin, thuhet se :*''Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës''*. Pra, me paraqitjen e kërkesës kreditore me dt.1 Gusht 2006 nga paditësi në procedurën e likuidimit, pranë AL-së, si autoritet kompetent për shqyrtimin e saj, si dhe me njoftimin e dt.21.02.2006 për përfundimin e punësimit të paditësit tek NSH-ja në fjalë, është ndërprerë afati i parashkrimit për një pjesë të detyrimit në të holla por jo edhe për pjesën tjetër të tij sepse paditësi, nuk ka prova se para dt.1 Gusht 2006, t'i jetë drejtuar qoftë gjykatës apo ndonjë autoritet kompetent më së voni deri 1 korrik 2002 për realizimin e kërkesës së tij, pra brenda tre viteve nga momenti kur NSH-ja, supozohet të mos ia ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj tij, si paditës.

Gjykata gjen se për periudhën kohore kur paditësit, i është mbyllur librezja e punës, pra me dt.21.02.2005 si dhe njoftimit të dt.21.02.2005 të AKP-së të dërguar në adresë të paditësit për përfundimin e punësimit tek NSH-ja në fjalë, nuk mund të ecin afatet e parashkrimit por se kërkesa e paditësit për pagat e pa paguara për periudhën kohore prej dt.1 Korrik 1999 e deri më 30 Korrik 2003, i është e parashkruar derisa pjesa e pagave të pa paguara për periudhën kohore duke filluar prej 1 Gusht 2003 e deri më 19.12.2005, nuk i është parashkruar dhe se pranimin e pjesës së kërkesëpadisë së paditësit, në shumën prej 6,776,00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH), "NIN Ramiz Sadiku" me seli në Prizren (në likuidim), gjykata e konsideron të arsyeshme dhe e konsideron si të drejtë dhe se ky qëndrim i kësaj gjykate bazohet në dispozitat nga neni 40.1.7 të Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, që në mënyrë taksative, citon se :*'' ... Kërkesat e pa siguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë''* dhe se këto kërkesa dhe interesa të kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 nga i njëjtit nen 40, po ashtu të Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në si dhe nenit 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr.03/L-212 derisa pjesa tjetër e kërkesëpadisë së tij mbi shumën e pranuar dhe për periudhën kohore 1 korrik 1999 e deri me 30 korrik 2003, kjo kërkesë e paditësit, është e parashkruar sepse paditësi, nuk ka ofruar prova se para dt.21.02.2001 Gusht 2006, t'i ishte drejtuar qoftë gjykatës apo te ndonjë autoritet kompetent më së voni deri 1 korrik 2002 për realizimin e kërkesës së tij, pra brenda tre viteve nga momenti kur NSH-ja, supozohet të mos ia ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj tij, si paditës pasi që këto kërkesa, kanë natyrë periodike dhe parashkruhen në afatin 3 (tre) vjeçar të tyre .

Gjykata po ashtu duke vepruar në bazë të dispozitave nga neni 37 par.3 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, paditësit, ia ka pranuar përpos kërkesën kryesore në shumën prej 313,76 €, edhe pjesën e saj në emër të kamatës ligjore prej 10 %, si kërkesë aksesore për detyrimin kryesor në të holla prej 3,137.66 € sepse në këtë nen, citohet se *''Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore''* derisa e ka refuzuar pjesën e kërkesës së paditësit e me të cilin e ka kërkuar edhe kamatë vonesën sipas ligjit në fuqij, si të pabazuar sepse në bazë të nenit 37

par.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, parashihet se : *''Dispozitat e këtij neni kanë efekt superior mbi dispozitat e mundshme kontradiktore të kontratave, zgjidhjeve, marrëveshjeve, aktgjykimeve apo rregullimeve tjera të lidhura nga Ndërmarrja apo në emër të saj''*.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet dhe kundërshtimet tjera të parashtruara të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat nuk janë të bazuara me dispozitat ligjore në fuqi në zbatim, andaj kërkesa e paditësit është pranuar e me përshkrimin e bërë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### ***Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës.***

Gjykata pas shqyrtimit të të gjitha provave, që gjenden në shkresat e lëndës, vlerësimi të tyre, konstatimit të gjendjes faktike, ka gjetur se pjesërisht nuk qëndron pretendimi i të paditurës, AKP-së, se kërkesa e paditësit për pagat e pa paguara për një periudhë kohore, është kërkesë jo e parashkruar sepse paditësi me bërjen e kërkesës së dt.1 Gusht 2006 tek AL-ja në procedurën e likuidimit, me këtë veprim, e ka ndërprerë afatin e parashkrimit për një pjesë të kërkesës së tij kurse qëndron pretendimi i të paditurës, AKP-së se një pjesë të kërkesës së tij për pagat e pa paguara dhe mbi shumën e pranuar, është e parashkruar pasi që kërkesa nga ana e paditësit, është dashur që të paraqitet në gjykatë apo ndonjë autoriteti kompetent brenda tre vjetëve, nga momenti kur NSh-ja, pretendohet të mos ketë përbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit, këtu paditësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, pra më së voni tre vite nga dt.20.01.2002, kur ndërmarrja u privatizua dhe punonjësve aktiv iu ndërpre marrëdhënia e punës me Njoftimin e dt.21 Shkurt 2006, dhe atë në shumën e refuzuar të saj nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "NIN Ramiz Sadiku" me seli në Prizren (në likuidim), siç parashihet me nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në sepse paditësi deri më datën 21.02.2005, ka qenë në punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore (NSh), "NIN Ramiz Sadiku" me seli në Prizren, si dhe si datë e pushimit të marrëdhënies së punës, ka qenë dt.21.02.2006 dhe se te Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "NIN Ramiz Sadiku" me seli në Prizren (në likuidim), ka pasur përvojën gjegjëse të punës, dhe sipas Listën e të ardhurave personale të pa paguara të punëtorëve të NSh "NIN Ramiz Sadiku" me seli në Prizren, i njëjti ka qenë pjesë e kësaj liste, dhe i renditur me nurmin 19 si dhe ka pasur paga gjegjëse mujore. Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore, kërkesëpadia e paditësit, Xh M nga fshati R i Komunës së Prizrenit, është pjesërisht e bazuar për një pjesë të kërkesëpadiës së tij dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit (AL), PRZ017-0004/0252 dt.10.03.2014, duhet të ndryshohet si dhe të detyrohet e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë – Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "NIN Ramiz Sadiku" me seli në Prizren (në likuidim), dhe që paditësit, duhet t'ia kompensoj shumën prej 6,776,00 € në emër të pagave të pa paguara për periudhën kohore prej dt.1 Gusht 2003 e deri më dt.19.12.2005 si dhe kamatën ligjore në lartësi prej 10% në shumën prej 677.60 €, si kërkesë aksesore nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "NIN Ramiz Sadiku" me seli në Prizren (në likuidim) e nga shuma totale e kërkuar prej 10,641.00 € për pagat e të pa paguara për periudhën duke filluar nga muaji 1 Korrik i vitit 1999 e deri me dt.19.12.2005 derisa për pjesën tjetër të kërkesëpadiës së paditësit, mbi shumën e pranuar dhe për periudhën kohore prej 1 Korrik 1999 e deri me dt.30.07.2003, Vendimin e AL-së, PRZ017-0004/0252 dt.10.03.2014 për NSh "NIN Ramiz Sadiku" me seli në Prizren (në likuidim), e vërtetoj pjesërisht si të drejtë dhe të bazuar në ligj kurse edhe pjesën e kërkesës e kërkesëpadiës së paditësit për pjesën e kamatë vonesës sipas ligjit në fuqi, si kërkesë aksesore, e refuzoj pjesërisht si të pabazuar.

Përfundimisht gjykata ka konstatuar se në rastin konkret pala kundërshtare gabimisht ka vepruar duke zbatuar dispozitën ligjore të cituara me lartë dhe bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën gjegjëse ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 153, 159, 190, dhe nenit 197 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

### **Shpenzimet Gjyqësore:**

Në bazë të nenit 62.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe Udhëzimit administrativ Nr. 01/2017 për unifikimin e taksave gjyqësore të KGJK përkatësisht nenit 13.3 dhe 13.9, të këtij udhëzimi dhe lidhur me nenin 449 dhe nenin 463 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe që pala e paditur, duhet t'i bart pjesërisht shpenzimet gjyqësore sepse në bazë të nenin 62 par.5 të Ligjit nr.06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), është përcaktuar se vetëm palës së suksesshme në procedurë (palës që e fiton gjykimin), i takon kompensimi i shpenzimeve gjyqësore dhe se paditësi, në rastin konkret, është i përfaqësuar nga avokati dhe se në këtë çështje kontestimore, pala paditëse, e ka fituar pjesërisht procesin gjyqësor, dhe për një pjesë të shpenzimeve të kërkuara, gjykata e bërë caktimin e tyre për shkak se caktimi i kësaj pjese është i bazuar kurse për një pjesë të tyre e refuzoj pjesërisht caktimin e tyre për shkak të pa bazueshmërisë së tyre, andaj gjykata ka vendosur që pala e paditur si palë në procedurë, t'i bart shpenzimet gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore.

## **DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2023:012871, 23.01.2024**

**Gjykatësi  
Agron Hoxhaj**

### **KËSHILLË JURIDIKE :**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).